



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 422, datë 09.10.2020**

**PËR**  
**ANULIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË LARTË**  
**GJYQËSOR NR.405, DATË 07.10.2020 DHE CAKTIMIN E NJË GJYQTARI NË**  
**GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË, PËR GJYKIMIN E DY ÇËSHTJEVE**  
**GJYQËSORE TË VEÇANTA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94, 95, 113 e 117 të Kodit të Procedurës Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 8 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në kërkesën nr.4994 prot., datë 08.10.2020 të gjyqtarës Oltjona Goxha, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**V E N D O S I :**

I. 1. Anulimin e pjesshëm të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr.405, date 07.10.2020, paragrafit I, nëndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, pikat 1 dhe 2, sa i përket caktimit në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: Edison Labi; Akuza: “Neni 100/1 i Kodit Penal” dhe çështjen penale me të pandehur: Aleksis Garunja; Akuza: “Neni 139 i Kodit Penal”, të gjyqtarës Oltjona Goxha, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Migena Laska, caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: Edison Labi; Akuza: “Neni 100/1 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Migena Laska, caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: Aleksis Garunja; Akuza: “Neni 139 i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**